



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**  
**V E N D I M**  
**K.P.P. 661/2017**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.09.2017 shqyrtoi ankesat me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së datë 03.08.2017, lidhur me s'kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "T&M Chemical Distribution" shpk, në procedurën e prokurimit "Kërkesë për Propozime" me numër REF-20942-07-15-2017, me objekt "Blerje detergjent për vitin 2017", me fond limit 4.000.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 03.08.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

**Ankimues:** "T&M Chemical Distribution" shpk  
Autostrada Tiranë – Durrës, Km 1.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Vlorë  
Adresa: Rruga "Zigur Lelo", Vlorë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

## Vlerësimi paraprak

I.1. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

## II

### Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.07.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me numër REF-20942-07-15-2017, me objekt “Blerje detergjent për vitin 2017”, me fond limit 4.000.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 03.08.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

II.2. Në datën 03.08.2017 është zhvilluar procedura e mësipërme e prokurimit.

II.3. Në datën 03.08.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

“Ermira Jahiqi (Lulaj)”	pa ofertë		skualifikuar
“T&M Chemical Distribution”	3.116.391	lekë	skualifikuar
“Euro Mega 2010”	3.194.435	lekë	kualifikuar
“Moena-Al 6”	3.371.631	lekë	skualifikuar
“Murati D”	3.724.505	lekë	skualifikuar
“M.B. Kurti”	3.777.520	lekë	skualifikuar
“Mega-Plast – 2L”	3.812.270	lekë	kualifikuar
“Shpiragu”	3.960.966	lekë	kualifikuar
“Atlantik 3”	3.998.510	lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 03.08.2017 operatori ekonomik “T&M Chemical Distribution” shpk, është njoftuar për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

1- *“Certifikata e gjëndjes financiare e paraqitur nga subjekti “T&M Chemical Distribution” shpk është lëshuar në datë 24.07.2017, kurse data për hapjen e ofertave ka qenë 31.07.2017. Në kriteret e veçanta të kualifikimit përcaktohet se ky document duhet të jetë lëshuar, jo më vonë se 5 ditë përpara hapjes së ofertave”.*

II.5. Në datën 09.08.2017, operatori ekonomik “T&M Chemical Distribution” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar s’kualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

[...]

*I nderuar autoritet!*

*“Shoqëria jonë “T&M Chemical Distribution” shpk, kundërshton vendimin tuaj për skualifikimin tonë me argumentin se vendimi juaj është i pa bazuar në ligjë, pasi referuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nenit 27 “Kontratat e Mallrave”, në asnjë prej pikave të kësaj dispozite nuk është e parashikuar që të kërkohet që operatori të paraqesë një deklaratë të gjëndjes financiare nga një ose më shumë banka sa 10 % e vlerës së kontratës që prokurohet. Ju bëjmë me dije së shoqëria jonë në vitet e fundit ka qenë fituese e rregullte kësaj procedure pranë autoritetit tuaj, duke përmbushur me sukses kontratën dhe duke furnizuar brënda çdo afati dhe specifikimi teknik mallrat e kërkuara nga ana juaj. Nuk duket aspak e drejtë edhe pse dokumenti ekziston në sistem por sipas jush i skaduar me një afat 24 orësh të përbëjë kusht skualifikimi”.*

*Kërkojmë rikualifikimin e shoqërisë tonë në këtë pikë.*

II.6. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, nuk rezulton ti jetë kthyer përgjigje operatorit ekonomik në lidhje me ankesën e bërë prej pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 24.08.2017, operatori ekonomik ankimues “T&M Chemical Distribution” shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës 7543/1 prot., datë 06.09.2017 protokolluar me tonën me nr. 1413/2prot., datë 08.09.2017 me objekt: *“Informacion mbi procedurën e prokurimit[...]*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1.Lidhur me pretendimin e palës ankimuese “T&M Chemical Distribution” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tij me arsyetimin se *“Certifikata e gjëndjes financiare e paraqitur nga subjekti “T&M Chemical Distribution” shpk është lëshuar në datë 24.07.2017, kurse data për hapjen e ofertave ka qenë 31.07.2017. Në kriteret e veçanta të kualifikimit përcaktohet se ky*

*document duhet të jetë lëshuar, jo më vonë se 5 ditë përpara hapjes së ofertave”.* Komisioni i Prokurimit Publik vëren:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pika 2.2 gërma (c) të dokumentave të tenderit të procedurës objekt ankimimi, nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

[...]

*2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:*

*(c). Një çertifikatë të gjëndjes financiare nga një ose më shumë banka në vlerën 10% të fondit limit, lëshuar jo më vonë se 5 ditë përpara ditës së hapjes së ofertave.*

[...]

III.1.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike në drejtim të disponueshmërisë të kriterit sa më sipër operatori ekonomik ka paraqitur:

- i. *Vërtetim nr KIB 209, datë 24.07.2017 lëshuar nga ProCredit Bank me anë të së cilës vërtetohet se: Operatori “T&M Chemical Distribution” shpk është klient i ProCredit Bank dega Tiranë Rr “Dritan Hoxha”, me nr IBAN..... Gjëndja e kësaj llogarie sot më datë 24.07.2017 është 403,386.75 lekë.*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma (c) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoritetikontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrëndhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjëndja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilanci, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur”;*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*

III.1.4. Në nenin 27 pika 3 “Kantarat e Mallrave” të VKM nr.914, datë, 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.*

III.1.5. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Vendosija e

kritereve të veçanta të kualifikimit ka si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

III.1.6. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik *“T&M Chemical Distribution”* sh.p.k, nuk ka vërtetuar përmbushjen e kërkesës së autoritetit kontraktor parashikuar tek *“Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2 gërma (c) “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”*, për paraqitjen e një certifikatë të gjëndjes financiare nga një ose më shumë banka në vlerën 10% të fondit limit, lëshuar jo më vonë se 5 ditë përpara ditës së hapjes së ofertave. Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin prokurimeve elektronik rezulton që certifikata e gjëndjes financiare e paraqitur nga ky operator ekonomik mban datën 24.07.2017, ndërkohë që autoriteti kontraktor bazuar në nenin 42 të LPP, nëpërmjet shtojcës nr. 1 ka kryer modifikimin e dokumentave të tenderit, duke shtyrë procedurën e prokurimit objekt ankimi me 5 ditë, konkretisht nga data 26.07.2017 ora 10:00 që ishte parashikuar hapja e ofertave, për në datë 31.07.2017 ora 10:00. Referuar argumentave të ankimuesit, Komisioni gjykon se operatori ekonomik ankimues pranon faktin se certifikata e gjëndjes financiare e dorëzuar prej tij nuk e përmbush kriterin e sipërcituar, pra që të jetë e lëshuar jo më vonë se 5 ditë përpara ditës së hapjes së ofertave. Komisioni gjykon se pretendimet e sipërcituara të operatorit ekonomik janë tërësisht të pabazuara dhe nuk gjejnë asnjë mbështetje ligjore. Argumentat e kërkuarit nuk lidhen në thelb me provueshmërinë e kapaciteteve financiare të kërkuara por kanë të bëjnë me justifikime të pabazuara të shkakut i cili sipas ankimuesit e ka penguar në dorëzimin e plotë të dokumentacionit provues lidhur me gjendjen financiare të këtij të fundit. Operatori ekonomik *“T&M Chemical Distribution”* sh.p.k. duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Komisioni gjykon se operatori ekonomik *“T&M Chemical Distribution”* sh.p.k ka pasur të gjithë kohën e mjaftueshme në dispozicion për t'u pajisur me vërtetimet përkatëse në përmbushje të kriterit të sipërcituar për realizimin e kësaj kontrate.

Sa më sipër, në kushtet kur operatori ekonomik mbi të cilin rëndon barra e provës, nuk ka vërtetuar me dokumentacionin përkatës se plotëson kriterin ekonomik financiar në përputhje me kriterin e sipërcituar të parashikuar nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për procedurën e prokurimit objekt ankimi, nuk mund të konsiderohet i vlefshëm

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “T&M Chemical Distribution” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me numër REF-20942-07-15-2017, me objekt “Blerje detergjent për vitin 2017”, me fond limit 4.000.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 03.08.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1413 Protokolli; Datë 24.08.2017**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Zv/Kryetar**  
**Leonard Gremshi**

**Anëtar**  
**Hektor Balluku**

**Anëtar**  
**Kleves Janku**

**Anëtar**  
**Odise Moçka**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**